

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm – gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit S. R. nga Prizreni, për shkak të veprave penale: pengimi i personit zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KPK, falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPK dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.5-1/2017 të datës 20.01.2017, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Mehreme Hoxha, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij Avokat F. Sh. nga Prizreni, me datë 14.03.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë

A K T G J Y K I M

I akuzuari

S. R. nga i ati H. dhe e ëma G. e lindur Sh. i lindur më datë nr. , ka të kryer shkollën në Prizren, ku dhe tani jeton në rrugën “ , fillore, punëtor i sigurimit, i pa martuar, me numër personal , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Me datë 02.01.2017 rreth orës 23:35 minuta, në Prizren rrugën “ ” e cila vazhdon në rrugën “ ”, e përdorë forcën dhe i pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe atë zyrtarët policor të cilët kanë qenë në kryerjen e detyrave, në atë mënyrë deri sa i akuzuari ka qenë duke e drejtuar automjetin e markës “Volsfagen Golf II”, me targa të regjistrimit , patrulla policore në përbërje nga zyrtarët policor Xh. J. dhe Sh. P. japin sinjal të ndalohet për të kryer kontrollin e dokumenteve personale dhe të automjetit, pas dhënies së sinjalit me anë të dritave vezulluese dhe alarm të automjetit zyrtar, i akuzuari nuk u bindet urdhrave dhe vazhdon vozitjen në mënyrë të vrullshme dhe kalon në rrugën “ ”, ku më pas i akuzuari largohet nga vetura me qëllim të shmangies së zyrtarëve policor, por zyrtari policor Sh. P. arrin që ta kap të akuzuarin, por pas rezistencës arrin të shmangët policit e zhvesh xhakëtën e cila ngel në dorë dhe me forcë shtynë i cili rrëzohet në tokë, ku edhe pëson lëndime trupore në dy këmbët dhe në dorë e djathtë, i shqyhet uniforma zyrtare, me të cilat veprime i pandehuri me përdorimin e forcës pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

Këso dore ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KPK.

II. Me datë, kohë dhe vende të njëjtë si në dispozitiv nën I. të aktgjykimit, pasi që ndalet nga ana e zyrtarëve policor, pas kontrollit të dokumenteve të automjetit të markës “Volsvagen Golf II” të cilën e vozite i akuzuari, gjatë kontrollit të dokumenteve të veturës vërtetohet se targa

e regjistrimit me numër 5... i takojnë një automjetit tjetër, kështu që i akuzuari me vetëdije përdor dokumentin e falsifikuar si origjinal gjatë qarkullimit në komunikacionin rrugor.

Këso dore ka kryer veprën penale falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPK.

III. Me datë, kohë dhe vende të njëjtë e përshkruar si në dispozitivin I. e II. të aktgjykimit, dëmton dhe e bënë të papërdorshme pasurinë e Policisë së Republikës së Kosovës - Stacionit Policor në Prizren, deri sa zyrtarët policor me automjetin e tyre zyrtar të markës "Shkoda" janë vu në ndjekje të akuzuarit i cili vozite automjetin e markës "Volfsagen Golf II" dhe iktë nga zyrtarët policor, me të arritur në rrugën tatëpjetë pa dalje, me qëllim të shmangies del nga vetura e cila ishte në lëvizje e godet automjetin zyrtar të policisë duke i shkaktuar dëme materiale në pjesën e përparme të veturës.

Këso dore ka kryer veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 46, 49, 50, 51, 73, 83 dhe nenit 409 par.5 lidhur me par.1 nenit 398 par.2 lidhur me par.1 dhe neni 333 par.1 të KPK, i shqipton dënimin dhe atë:

DËNIM ME KUSHT

Për veprën penale nën I. të shqiptimit të aktgjykimit, vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk kryen vepër të re penale.

DËNIM ME GJOBË

- Për veprën penale nën II. të shqiptimit të aktgjykimit shqipton dënimin me gjobë në lartësi prej 1.000 € (një mijë euro), për veprën penale nën III. të shqiptimit të aktgjykimit i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej 240 € (dyqind e dyzet euro).

- ashtu që në kuptim të nenit 80 par.1 të KPK i shqipton:

DËNIM UNIK

- me gjobë në lartësi prej 1.240 € (njëmijë e dyqind e dyzet euro), në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe në masën e arrestit shtëpiak, prej datës 12.01.2017 e gjer më datën 14.03.2017.

Të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues në pajtim me nenin 69 par.1 të KPK, merren targat e regjistrimit me numër _____, si mjet i kryerjes së veprës penale si nën II. të dispozitivit të aktgjykimit.

Të dëmtuarit Sh₁ (S₁) P nga fshati K Komuna e Prizrenit dhe Xh. (S₂) J nga fshati M. - H Komuna e Prizrenit – që të dy zyrtar policor në Stacionin

Policor në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Ar sy e tim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.5-1/2017 të datës 20.01.2017, ndaj të akuzuarit S. R nga Prizreni, për shkak të veprave penale: pengimi i personit zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KPK, falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPK dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK.

Në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga e prokurorit të shtetit, gjykata shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas konsultimit me mbrojtësin e tij deklaroi se nuk e kundërshton asnjë provë në të cilën mbështetet aktakuza, andaj edhe në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës – konkretisht për veprat penale me të cilat ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike më datë 02.01.2017 në orët e vona të natës rreth orës 23:35 minuta, në Prizren në rrugën “.....”, i akuzuari S. R. gjatë qarkullimit në komunikacionin rrugor me automjetin e tij të markës “Volsfagen Golf II”, me targa të regjistrimit “.....” nuk respekton urdhrat e zyrtarëve, nuk ndalet, me qëllim të kontrollimit të dokumenteve të identifikimit dhe dokumenteve të veturës, edhe pse të njëjtit japin sinjal të ndalohej. Mirëpo zyrtarët duke vepruar në pajtim me detyrat e punës me qëllim të kryerjes së kontrollit, japin sinjal me anë të dritave vezulluese dhe alarmit të automjetit zyrtar, por i akuzuari edhe më tej nuk u bindet urdhrave dhe vazhdon vozitjen në mënyrë të vrullshme dhe kalon në rrugën “.....” Më pas i akuzuari largohet nga vetura me qëllim të shmangies së zyrtarëve policor, por zyrtari policor Sh. P arrin që ta kap atë por pas rezistencës së dhënë arrin të shmanget policit e zhvesh xhakët e cila ngel në dorë dhe me forcë shtynë i cili rrëzohet në tokë. I dëmtuari – zyrtari policor nga ky veprim pëson lëndime trupore në dy këmbët dhe në dorë e djathtë, i shqyhet uniforma zyrtare, me të cilat veprime i pandehuri me përdorimin e forcës pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

Po në këtë situatë zyrtarët policor gjatë kontrollit, konstatojnë se tabelat të cilat i kishte automjeti i markës “Volsvagen Golf II” i takonin një veturë tjetër, të cilën voziste i akuzuari natën kritike. Prandaj i akuzuari me vetëdije e përdor dokumentin e falsifikuar si origjinal gjatë qarkullimit në komunikacionin rrugor. Gjatë rezistencës së dhënë nga ana e akuzuarit S. R. dëmtohet edhe automjeti zyrtar i Policisë së Republikës së Kosovë, të cilin e kanë pasur në përdorim patrulla policore gjatë kryerjes së detyrave të veta. Kështu deri sa zyrtarët policor me automjetin zyrtar të markës “Shkoda” janë vu në ndjekje të akuzuarit, në momentin deri sa i njëjti

me automjetin e tij ishte duke ikur nga zyrtarët policor, me arritur në rrugën tatëpjetë pa dalje i akuzuari me qëllim të shmangies së zyrtarëve policor del nga vetura e cila ishte në lëvizje, lëvizje e godet automjetin zyrtar të policisë duke i shkaktuar dëme materiale në pjesën e përparme të veturës.

Gjykata para se të hap senacën fillestare, paraprakisht pas shiqimit të shkresave të lëndës, analizës së deponimeve të dëmtuarve – zyrtarëve policor të akuzuarit dhe fotodokumentacionit si edhe gjatë seancës fillestare, ka ardhë në përfundim se i akuzuari para se të kryej veprat penale ka vepruar me vetëdije të plotë, nuk është nështruar urdhërave të policisë dhe ka ikur nga vendi i ngjarjes, sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta, për pasojat të cilat janë shfaqur dhe ka dëshiruar kryerjen e këtyre veprimeve. Pra në rastin konkret gjykata në këtë mënyrë edhe ka vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike. Nga kjo del se në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprave penale: pengimi i personit zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KPK, falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.2 lidhur me par.1 të KPK dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga e akuzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës, me ç'rast edhe gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ndonjë provë e cila është e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprat penale me të cilat ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, sepse mbështet në fakte që përmban aktakuza nga se i akuzuari prej fillimit të hetimeve ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat të akuzuarit i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës të cilat prova asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenësore të veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpalli fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysht të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata si rrethanë rënduese ka marrë faktin se i akuzuari është përsëritës i veprave penale, sepse pranë kësaj gjykate është dënuar me vendim meritore dhe pas një kohe relativisht të shkurtër ka ndërmarrë veprime kundërligjore në dëm të dëmtuarve, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysht faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprave penale, është i gjendjes së dobët ekonomike dhe premtimin se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla kundërligjore, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi, duke menduar se dënimet e shqiptuara i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi dënimin plotësues marrja e sendit është marrë në pajtim me nenin 69 par.1 të KPK.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarve në kontest të rregullt kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është vendosur në kuptim të nenit 463 par.1 e 2 të KPPK.

Vendimi për shpenzimet procedura dhe paushallin është vendosur në kuptim të nenit 450 të KPPK.


Nga të lartë cekurat është vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.135/2017 të datës 14.03.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka



Gjyqtarja
Teuta Krusha



UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.